



KANTON AARGAU

**DEPARTEMENT  
GESUNDHEIT UND SOZIALES**

Abteilung Gesundheit

**Andreas Obrecht**

Drejtuar i programit Covid-19  
Bachstrasse 15, 5001 Aarau  
Telefon direkt 062 835 23 73  
Telefon zentral 062 835 29 30  
Fax 062 835 29 39  
andreas.obrecht@ag.ch  
www.ag.ch/dgs

Drejtuar kujdestarëve të nxënësve  
dhe nxënësve

16 gusht 2021

**Vaksina covid-19 për të rinjtë duke filluar nga 12 vjeç në shkollat e arsimit të mesëm të lartë të Aargau**

Të nderuar zonja dhe zotërinj

Në fund të qershorit ju kemi informuar, që të rinjtë duke filluar nga 12 vjeç mund të vaksinohen kundër covid-19 në qendrat e vaksinimit të spitaleve të kantonit Aarau AG dhe në spitalin e kantonit Baden AG. Kjo mundësi vazhdon të mbetet në fuqi.

Përafërsisht, duke filluar nga fundi i Gushtit 2021, të rinjtë mund të vaksinohen edhe privatisht pranë klinikave të ndryshme për fëmijë dhe të mjekëve të familjes. Nëse dëshironi të përfitoni nga kjo mundësi, drejtojuuni më mirë direkt klinikës për fëmijë ose mjekut të familjes së fëmijës tuaj dhe pyesni nëse atje kryhen vaksina. Përafërsisht, duke filluar nga fundi i gushtit, në të gjitha qendrat e vaksinimit është i mundur vaksinimi i të rinjve. Kjo gjë lidhet me miratimin e vaksinës Moderna për këtë grupmoshë.

Duke filluar nga shtatori, kantoni Aargau do të kryejë vaksinimin covid-19 në shkollë edhe te shkollat e arsimit të mesëm të lartë të Aargau. Të dhënat e sakta të vaksinimit të shkollës të vajzës/djalit tuaj ju bëhen juve me dije direkt nga shkolla.

Nëse ju si kujdestar dhe fëmija juaj të jeni dakord me këtë gjë, dhe nuk ekzistojnë kufizime të rënda shëndetësore, vaksinat covid-19 në shkollë mund të kryhen nga skuadrat e lëvizshme të vaksinimit të fushatës së vaksinimit të Aargau.

Të rinjtë duhet që për vaksinimin në shkollë të sjellin me vete dokumentet si më poshtë:

- Deklaratën e nënshkruar të dakortësisë (formularin për këtë gjë do ta merrni në kohën e duhur nga shkolla).
- Karta e sigurimit shëndetësor
- ID/pasaportë udhëtimi/dokumenti i identifikimit si i huaj
- Fletoren e vaksinimit, për sa kohë vaksina covid-19 duhet të shënohet atje.

Për informacione të mëtejshme mbi vaksinën covid-19 referojuni linqeve të mëposhtme:

- [Kantoni Aargau: Vaksina coronavirus](#)
- [Autoriteti Federal për Shëndetin BAG: Fletë informuese për të rinjtë](#)
- [Autoriteti Federal për Shëndetin BAG: Vaksina coronavirus](#)
- [Swissmedic: Video shpjeguese](#)
- [Kantoni Aargau: Video vaksinimi covid-19](#)

Sinqerisht



Andreas Obrecht  
Drejtore i programit Covid-19



PD Dr. med. Christoph Fux  
Infektologjia



Dr. med. Andrée Friedl  
Infektologjia